

VENDIM
Nr. 42, datë 5.6.2019

PËR REVOKIMIN E LICENCËS SË BANKËS SË KREDITIT TË SHQIPËRISË SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të nenit 107, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe pasi u njoh me vendimin datë 22.1.2019 të Asamblesë së Aksionerëve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë sh.a., me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të revokojë licencën nr. 15, datë 28.8.2002, të Bankës së Kreditit të Shqipërisë sh.a., për shkak të fillimit të procesit të likuidimit vullnetar nga ana e vetë bankës.
 2. Ngarkohet Banka e Kreditit të Shqipërisë sh.a. të dorëzojë pranë Bankës së Shqipërisë licencën e revokuar.
 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e procesit të likuidimit vullnetar të Bankës së Kreditit të Shqipërisë sh.a., deri në përfundimin e tij dhe njoftimin e këtij vendimi Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.
 4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko